

VENDIM
Nr. 596, datë 18.10.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIMI I FASADAVE TË PALLATEVE NË SHËTITOREN “MIQËSIA” DHE
RRUGËS SË TREGUT, SI DHE REHABILITIMI I ZONËS PAS PALLATEVE TË ISH-
MAPOS”, POLIÇAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikimi i fasadave të pallateve në shëtitoren “Miqësia” dhe rrugës së tregut, si dhe rehabilitimi i zonës pas pallateve të ish-mapos”, Poliçan.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Poliçan.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë sipërfaqe “trual” dhe “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 9 130 543 (nëntë milionë e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 9 130 543 (nëntë milionë e njëqind e tridhjetë mijë e pesëqind e dyzet e tre) lekësh, do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Poliçan.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Poliçan.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Poliçan, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar dhe Bashkia Poliçan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

**TABELA E VLERAVE TË OBJEKTEVE PËR EFEKTIN E SHPRONËSIMIT
PËR INTERES PUBLIK**

Llogaritjet janë kryer duke u mbështetur në:

Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”;

Udhëzimin nr. 3, datë 28.12.2015, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2016”;

VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”;

VKM-në nr. 401, datë 23.10.1989, “Për miratimin e normave të reja të amortizimit”

Nr.	Pronari	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i objektit	Sipërfaqe truall (m²)	Sipërfaqe ndërtimi (m²)	Çmimi i truallit lekë/m²	Vlera truall	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera truall dhe ndërtësë	Konfirmimi nga ZVRPP-ja Skrapar
1	Engjellush Hysko	3019	12/185	Garazhd	83	83	539	44737	551,830	596,567	Po
2	Enver Lulaj	3019	12/199	Lokal	109	109	539	58751	2,006,044	2,064,795	Po
3	Enver Lulaj	3019	12/227	Garazhd	35	35	539	18865	602,564	621,429	Po
4	Safet Kacani	3019	12/197	Dyqan	0	30	539	0	749,738	749,738	Po
5	Mimoza Ylli Elona Sako Ylli Delian Sako Ylli	3019	12/193	Lokal	0	30	539	0	1,035,367	1,035,367	Po
											Po
											Po
6	Kastriot Murati	3019	12/66	Dyqan	0	40	539	0	927,125	927,125	Po
7	Hamza Elezi	3019	12/67	Garazhd	20	20	539	10780	312,840	323,620	Po
8	Haredin Muço	3019	12/25	Dyqan	20	20	539	10780	326,537	337,317	Po
9	Lulezim Saliati	3019	12/26	Garazhd	0	38	539	0	347,048	347,048	Po
10	Fatbardh Xhamallati	3019	12/27	Godine	0	60	539	0	744,950	744,950	Po
											Po
11	Hatem Kurti	3019	12/30	Godine	0	38	539	0	728,327	728,327	Po
12	Shaqir Kaja	3019		Dyqan	0	15	539	0	193,430	193,430	Mungesë dokumentacioni
13	Nuhu Brahmasi	3019	12/190	Godine	0	49	539	0	390,760	390,760	Mungesë dokumentacioni
14	Xhuljeta Zyla	3019	12/190	truall	130	0	539	70070		70,070	Po
								213983	8,916,560	9,130,543	
SHUMA TOTALE E SHPRONËSIMEVE										9,130,543	